

# Kur fëmijët vijjnë të parët



Ky material është financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect. Radiohjalpen dhe We Effect jo domosdoshmërisht bien dakort me mendimin e shprehur. Vetëm Autori është përgjegjës për përmbajtjen.

Punoi & Redaktoi:

**Marsela Isaku**

Koordinatorë Projekti  
Unioni Amaro-Drom”

©Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro-Drom”

Adresa: Rr. Sulejman Pasha,

Lagjia 4, P.2, Shk.3

Telefon/Fax: 00355 4 248925 & 231391

E-mail: amarodrom@abissnet.al

Website: www.unioniamarodrom.com

Tiranë, Shqipëri

# Parathënie

Ky botim publikohet në kuadër të projektit "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Romë" financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect, i cili zbatohet nga Unioni "Amaro-Drom në zonat: Korçë, Shkodër, Moravë-Berat, Baltëz-Fier.

Botimi është në funksion të aktiviteteve të projektit dhe njëkohësisht të çështjeve që lidhen me arsimimin e fëmijëve Rom në Shqipëri.

Arsimimi i fëmijëve Rom, është një nga fushat prioritare të Unionit "Amaro-Drom" që në momentet e para të krijimit pasi "Pa arsim nuk ka zhvillim, nuk ka integrim, nuk ka të ardhme".

Një rëndësi e veçantë nga Unioni "Amaro-Drom" i është kushtuar kujdesit të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, ku një sërë projektesh të zbatuara, kanë patur në fokus edukimin parashkollor.

Vitet e hershme të jetës, janë të rëndësishme për zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijës dhe vendosin themelet për fitimin e aftësive që ndikojnë në të ardhmen.

Mirëqënia dhe shëndeti i fëmijëve tanë, është një çështje që na prek të gjithëve dhe të gjithë duhet të jemi pjesë e zgjidhjeve për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët.

Një falenderim i veçantë shkon për të gjithë aktorët të cilët kontribuojnë për arsimimin e fëmijëve Rom në Shqipëri. Dëshiroj të falenderoj për mbështetjen në realizimin e këtij projekti, donatorët, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, drejtuesit e Drejtorive Arsimore Rajonale në Korçë, Shkodër, Fier dhe Berat, Drejtoritë dhe edukatorët e kopshteve të projektit dhe stafin e projektit.

Çdo fëmijë duhet të ndihet i vlerësuar dhe të ketë mundësi të zhvillojë potencialin e tij. Le të përpiqemi të gjithë së bashku t'u ofrojmë fëmijëve tanë një mjedis të sigurt, të ngrohtë dhe gjithpërfshirës.



Sinqerisht,  
**Skënder Veliu**  
Drejtor Ekzekutiv  
Unioni Amaro Drom



# Përmbajtja

Parathënie .....	3
Rreth projektit.....	6
Dispozitat normative për arsimin parashkollor .....	8
Aktivite në kuadër të projektit .....	10
Konferencë kombëtare “Së bashku për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve rom në Shqipëri” .....	11
Shkëmbim eksperience midis stafeve edukative të kopshteve në Korçë.....	16
Fuqizimi i kapaciteteve të liderave lokalë të Komunitetit Rom .....	18
Tryeza të rumbullakta me ofruesit e shërbimeve në nivel lokal .....	20
Sesione informimi mbi të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e regjistrimit civil .....	22
Trajnim për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve .....	24
Shkëmbim eksperience midis stafeve edukative të kopshteve në Shkodër .....	27
Krenare për kontributin që mund të jap për fëmijët rom – eksperiencë personale. ....	29
Puna me fëmijët rom më jep kënaqësi .....	31
Kontributi i “Fshtatit të paqes” në arsimimin e fëmijëve rom dhe egjiptianë në Shkodër .....	33
Informacion mbi shkollën “Liria” në Shkodër.....	35
Edukimin e fëmijës e ndërton nëna .....	37

# RRETH PROJEKTIT



**P**rojekti "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Romë" financohet nga Radiohjalpen dhe We Effect, dhe zbatohet nga Unioni "Amaro-Drom".

Ky projekt do të zbatohet në zonat: Korçë, Shkodër, Moravë-Berat, Baltëz-Fier, përgjatë periudhës Qershor 2015 - Dhjetor 2016.

Projekti ka për qëllim përmirësimi i kushteve të jetesës së fëmijëve Rom dhe fëmijëve të disavantazhuar jo-Rom, konkretisht duke adresuar mungesën e mundësive për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, frekuentimin në nivel të ulët të shkollës dhe përjashtimin social.

Projekti i vjen në ndihmë 159 fëmijëve të regjistruar për vitin shkollor 2014-2015, nga të cilët 66 janë rom dhe 70 janë egjiptianë.

## Objektivat



## Aktivitetet



## Objektivat e projektit janë:

- Përmirësimi i aksesit ndaj shërbimeve cilësore të fëmijërisë së hershme;
- Reduktimi i pabarazisë ekonomike për të patur akses në shërbimet e edukimit parashkollor për fëmijët Rom;
- Rritja e ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e regjistrimit civil, edukimit të hershëm dhe shëndetit të fëmijëve;
- Përmirësimi i shëndetit të fëmijëve dhe mentalitetit të prindërve për parandalimin e sëmundjeve;
- Regjistrimi civil, rritja e kapacitetit të antarëve të komunitetit rom për zgjidhjen e rasteve të regjistrimit civil.

## Aktivitetet kryesore të projektit janë:

- Lehtësimi i aksesit dhe regjistrimit të fëmijëve Rom të moshës 3-6 vjec në kopësht dhe të kalimit të fëmijëve 6- vjecar në shkollë;
- Vlerësim nevojash, regjistrim, monitorim dhe vlerësim i progresit të fëmijëve;
  - Trajnim në punë për edukatorët;
  - Trajnim për Liderat e komunitetit;
- Sesione trajnuese mbi të drejtat e fëmijëve, zhvillimin e fëmijërisë së hershme dhe prindërimin;
- Festimi i Ditës Ndërkombëtare të Romëve dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve Rom;
  - Konferencë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve;
- Ofrimi i shërbimit shëndetësor për fëmijët e targetuar dhe informim i prindërve të tyre;
- Regjistrimi civil i fëmijëve dhe ngritja e kapacitetit të prindërve Rom për të zgjidhur problemet e regjistrimit civil.

# DISPOZITAT NORMATIVE PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR\*

\* - burimi i informacionit: Dispozitat normative për arsimin parashkollor  
Agron Pullumbi, Gusht '2013



## **NENI 5**

**Organizimi i kopshteve publike. Ndjekja e arsimit parashkollor. Procedurat e regjistrimit të fëmijës në kopshtin publik.**

1. Kopshtet:

- a. Janë me ushqim ose pa ushqim;
- b. Kanë grupin e parë, të dytë dhe të tretë (klasa përgatitore);
- c. Funkcionojnë gjatë gjithë vitit kalendarik.

2. Fëmija, që ditën e fillimit të vitit shkollor, mbush moshën 3, 4 ose 5 vjeç, ka të drejtë të regjistrohet përkatësisht në grupin e parë, të dytë, të tretë. Fëmija regjistrohet në grupin që i përket moshës së tij.

3. Fëmija 6 vjeç ka të drejtë të qëndrojë në kopsht deri një ditë para fillimit të klasës së parë.

4. Grupi i tretë (klasa përgatitore) ngrihet në kopsht ose në shkolla të arsimit bazë.

5. Regjistrimi i fëmijëve në kopshtet publike nis në datën e fillimit të regjistrimit në shkollën e arsimit bazë.

6. Regjistrimi i fëmijës në kopsht bëhet me këto dokumente:

- a) Certifikata e lindjes së fëmijës;
  - b) Vërtetimi i vaksinimeve nga qendra shëndetësore.
- Për kopshtet pa ushqim jepet adresa e fëmijës. Për kopshtet me ushqim jepen adresa e fëmijës dhe vërtetimi i marrëdhënies së punës së njërit prind.

7. Raste të veçanta:

a) Kur prindi nuk ka çertifikatën e lindjes së fëmijës, drejtoresha e kopshtit lejon që fëmija të ndjekë grupin, sipas moshës së pretenduar nga prindi dhe i cakton prindit, sipas rrethanave, një afat për paraqitjen e çertifikatës;

b) Kur prindi nuk ka vërtetimin e vaksinimeve të fëmijës, drejtoresha e kopshtit i kërkon prindit t'i drejtohet qendrës përkatëse shëndetësore dhe pas marrjes së vërtetimit, e regjistron fëmijën.

## **NENI 6**

**Kurrikula**

1. Kurrikula e kopshtit bazohet në këto dokumente:

- a. Standardet e përmbajtjes;
- b. Standardet e arritjeve;
- c. Programet e arsimit parashkollor për çdo grup.

2 Programet e miratuar nga ministri zbatohen në kopsht për periudhën e vitit mësimor. Gjatë verës, veprimtaria e kopshtit planifikohet nga mësueset dhe miratohet nga drejtoresha e kopshtit.

3 Mësuesja e kopshtit harton, në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve, planin vjetor të veprimtarive të grupit i cili miratohet nga drejtoresha e kopshtit.

4 Mësuesja e kopshtit vlerëson fëmijët një herë në tre muaj, sipas fushave të zhvillimit.

5 Mësueset e kopshtit bashkëpunojnë me prindërit, me qëllim që veprimtaritë që zhvillohen në kopsht dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën.

# AKTIVITETE

Në kuadër të projektit



**Konferencë kombëtare  
“Së bashku për mbrojtjen e të drejtave të  
fëmijëve rom në Shqipëri”**



Në kuadër të 20 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve, Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri "Amaro-Drom" organizoi Konferencën Kombëtare "Së bashku për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve rom në Shqipëri".

Kjo Konferencë, kishte si qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve rom në Shqipëri, prezantimin e iniciativave mbështetëse si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve të këtij komuniteti.

## Pjesëmarrësit

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Avokati i Popullit, **Z. Igli Totozani**, përfaqësues nga zyra Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve; Përfaqësuesja për Shqipërinë dhe Kosovën e Roma Education Fund (REF), Drejtorë shkollash nga zona të ndryshme të Shqipërisë, antarë të komunitetit rom dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

**M**iratimi i kësaj Konvente shënoi një pikë kthese, duke bërë të njohur në mbarë botën që fëmijët nuk janë vetëm subjekte të mbrojtjes, por, gjithashtu, mbajtës të të drejtave civile dhe politike, theksoi **Z. Veliu**.

**A**i gjatë fjalës së tij, bëri thirrje për të gjitha autoritetet qeveritare dhe të gjithë aktorët e shoqërisë civile, të kenë më tepër në vëmendje fëmijët e Komunitetit Rom dhe nevojat e tyre. **Z. Veliu** gjatë fjalës së tij u ndal në prezantimin e problematikave kryesore me të cilat përballlet komuniteti Rom në Shqipëri. Njëkohësisht, ai informoi në lidhje me mbështetjen e ofruar nga Unioni "Amaro-Drom" ndër vite në fusha të ndryshme, me qëllim nxitjen e përfshirjes sociale të komunitetit Rom në Shqipëri dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij komuniteti.

Hapja e aktivitetit u bë nga **Z. Skënder Veliu**, Drejtor Ekzekutiv **Unioni "Amaro-Drom"**. Në fjalën e tij **Z. Veliu** foli në lidhje me rëndësinë e datës 20 Nëntor, e cila është shënuar në kalendar si "Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve". Përcaktimi i kësaj dite ka marrë shkas nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 20 Nëntor 1989 dhe ka hyrë në fuqi si ligj ndërkombëtar në vitin 1990.

1

zhvillim komuniteti

2

edukim parashkollor

3

edukim dhe formim profesional

4

luftën ndaj trafikimit të fëmijëve

5

mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit

6

ulja e varfërisë nëpërmjet projekteve të gjenerimit të të ardhurave, manaxhim dhe zgjidhje konfliktesh, shërbime shëndetësore

focus

Në përfundim të fjalës së tij, Z. Velu përcolli mesazhin se çështja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, është një çështje e të gjithë shoqërisë shqiptare, qeverisë dhe politikës. Ajo duhet të jetë në vëmendje përtej kësaj dite. Kjo do të shënojë edhe besimin e komunitetit rom drejt të ardhmes!



Marrjen e masave për sistemimin e tregtarëve rom në vende ku ata mund të ushtrojnë aktivitetin tregtar në mënyrë të barabartë me të tjerët;

- Marrjen e masave për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual;
- Marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve që cenojnë dinjitetin e individit për shkak të përkatësisë së tij etnike dhe trajtimin me efektivitet të denoncimeve të bëra nga qytetarët pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike;
- Për trajtimin me përparësi të familjeve rome për përfitimin e banesave sociale me qera etj.

KMD bazuar në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi ka shqyrtuar dhe iniciuar një sërë ankesash në fushën e arsimit – përmendi znj. Bushati.

Një problematike e hasur në fillim të këtij viti shkollor është mospajsa në kohë me tekste shkollore për fëmijët e komunitetit rom për shkak procedurave të ndjekura nga institucionet përgjegjëse për këtë problem. Komisioneri ka filluar kryesisht ndjekjen e kësaj çështjeje në disa rrethe si Gjirokastrë, Fier, Vlorë, Tiranë, Elbasan dhe ka konstatuar problematikat procedurale të cilat çojnë në vonesa në shpërndarje në kundërshtim me legjislacionin përkatës.

Një nga problematikat e trajtuara nga KMD është edhe problemi i segregimit të fëmijëve rom dhe egjiptian në shkollat e ndryshme. Rasti i fundit që KMD ka trajtuar është rasti i shkollës "Naim Frashëri" në Korçë.

KMD pasi hetoi dhe analizoi me vëmendje situatën arriti në: Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian të Shkollës "Naim Frashëri", Korçë, për shkak të të racës dhe etnisë, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë. Duke vendosur:

Detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë të marrë masa të menjëhershme, me qëllim përmirësimin e situatës dhe ndryshimin e raportit të nxënësve që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe komuniteteve të tjera, në Shkollën "Naim Frashëri", Korçë.

Detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë, të marrin masa të menjëhershme për sensibilizimin e stafit të institucioneve arsimore në varësi, në mënyrë që të shmangët veçimi apo segregimi i fëmijëve rom/egjiptian në shkollat apo klasa të caktuara.

Me të njëjtën problematikë KMD po shqyrton rastin e segregimit të nxënësve të komunitetit rom që mësojnë pranë shkollës vartëse "Avdyll Avdia", në lagjen Stan, të fshatit Moravë, Berat. Procedura e hetimit vazhdon për këtë rast.

**N**ë përfundim, referuar edhe Progres Raportit të fundit të Komisionit Europian për Shqipërinë

- Romët dhe egjiptianët kanë kushte jetese shumë të vështira, përjashtim të shpeshtë social dhe diskriminim për shkak të zbatimit të paefektshëm të politikave dhe një bashkëpunim ndërinstitucional të varfër. Si dhe kërkohet që Shqipëria: "të përmirësojë kushtet e jetesës për romët dhe egjiptianët, të dëshmojë përparim lidhur me rezultatet konkrete në fushën e antidiskriminimit"

Mendoj që të gjithë bashkë kemi shumë punë për të bërë për të arritur standartet u shpreh znj. Bushati.

Në këtë aktivitet ishte e pranishme gjithashtu edhe znj. Anila Bregu, përfaqësuese e Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve e cila foli në lidhje me angazhimet më të fundit të kësaj Agjencie për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Gjatë fjalës së saj, znj. Bregu foli mbi planin e veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge. Ajo theksoi se në vitin 2014 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge". Dhe më pas në Qershor të vitit 2015 u përfshi në marrëveshje gjithashtu edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Plani i Veprimit, filloi të zbatohet fillimisht në Tiranë, në ndihmë të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Znj. Bregu foli gjithashtu për rolin e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimin me Policinë e Shtetit. Gjatë fjalës së saj përmendi disa nga shërbimet që janë ofruar për fëmijët në situatë rruge gjatë menaxhimit të rasteve si: Këshillim dhe ofrim shërbimesh në qendrat ditore, regjistrimi i fëmijëve në kopshte dhe shkolla, pajisja me certifikatë, vaksinimi, paketa ushqimore bazë, referim dhe ndërmjetësim në zyrat e punës për antarët madhorë të familjeve në situatë rruge etj. Në fund të fjalës së saj, znj. Bregu foli mbi nevojën e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve me qëllim mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri.

Në këtë aktivitet ishte e ftuar edhe znj. Marsela Taho, përfaqësuesë e Roma Education Fund për Shqipërinë dhe Kosovën. Znj. Taho përmendi se REF prej shumë vitesh ka kontribuar në rritjen e nivelit të edukimit të fëmijëve të komunitetit Rom në Shqipëri. Ajo theksoi se ndihej mirë për faktin se tashmë ekziston një numër i konsiderueshëm të rinjsh rom të cilët vazhdojnë apo kanë përfunduar studimet e larta, ndryshe nga situata e cila paraqitej para disa vitesh në Shqipëri. Znj. Taho foli në lidhje me programet të cilat mbështet REF në Shqipëri dhe arritet në kuadër të projekteve të zbatuara.

Aktiviteti vijoi me ndërhyrje nga ana e personave të pranishëm në sallë. Drejtorët e shkollave dhe përfaqësues të stafeve edukative folën në lidhje me situatën e edukimit në zonat e tyre dhe theksuan se fëmijët Rom trajtohen në të njëjtën mënyrë si gjithë fëmijët e tjerë. Ata përmendën nevojën që ekziston për më tepër mbështetje veçanërisht në përmirësimin e infrastrukturës në kopshte dhe shkolla.

SHKËMBIM EKSPERIENCË  
MIDIS STAFEVË  
EDUKATIVE TË  
KOPSHTEVË NË KORÇË



29-30 Tetor



Kopshti  
"Lulet e Vogla"



Në datat 29-30 Tetor, në kopshtin "Lulet e Vogla" Korçë u zhvillua aktiviteti shkëmbim eksperience midis stafeve edukative të kopshteve "Liria" Shkodër, "Hamil" Fier dhe kopshti i lagjes "Stan-Moravë" Berat.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Rome" financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect, i cili zbatohet nga Unioni "Amaro-Drom në zonat e sipërpërmendura.



Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të kontribuonte në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shkëmbimin e eksperiencës midis stafeve edukative të kopshteve të targetuara nga projekti. Në këtë aktivitet morën pjesë edukatorët, drejtorët e kopshteve dhe koordinatorët lokalë të zonave të projektit.

Pjesëmarrësit ndoqën zhvillimin e një ore mësimore në kopshtin e Korçës, ku patën mundësinë të njihen me metodat e mësimdhënies dhe se si organizohet një orë mësimi në këtë kopsht. Gjithashtu, stafet edukative diskutuan midis tyre në lidhje me modelet pozitive dhe sfidat me të cilat ata përballen gjatë përditshmërisë së tyre në kopsht.

Koordinatorja lokale e Korçës znj. Donika Rapush i informoi pjesëmarrësit në lidhje me historikun e kopshtit; kur është hapur, aktorët kryesorë që kanë kontribuar, problemet kryesore me të cilat janë përballur etj. Në këtë aktivitet pati gjithashtu edhe përfaqësues nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Korçës, të cilët përshëndetën pjesëmarrësit dhe falenderuan organizatën "Amaro-Drom" për mundësimin e këtij aktiviteti. Këto lloj aktivitetesh inkurajohen për faktin se ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe adaptimin e modeleve pozitive.

Pas vizitës në kopsht, pjesëmarrësit realizuan një vizitë më Muzeun e Mësonjëtores së Parë Shqipe ku panë nga afër ambientet e shkollës së parë të gjuhës shqipe.

# Fuqizimi i kapaciteteve të liderave lokalë të komunitetit rom



**30 Korrik 2015,**  
Unioni  
“Amaro-Drom”

**M**ë datë 30 Korrik 2015, Unioni “Amaro-Drom” organizoi një trajnim me pjesëmarrjen e rreth 30 liderave të komunitetit Rom, lehtësuesve, mediatorëve dhe koordinatorëve të projekteve të ndryshme në nivel kombëtar

**A**ktiviteti u hap me një fjalë përshëndetëse nga ana e Drejtorit Ekzekutiv të Unionit “Amaro-Drom”, Z. Skënder Veliu. Gjatë fjalës së tij, ai vlerësoi angazhimin e të gjithë aktivistëve Rom, të cilët ndër vite kanë kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së antarëve të komunitetit Rom në zonat ku ata veprojnë. Pavarësisht faktit se disa prej tyre kanë një eksperiencë të gjatë pune në komunitet, gjithmonë është e nevojshme pasurimi i informacionit dhe aftësimi i punonjësve të terrenit me teknika të reja të punës në komunitet.



**A**ktiviteti trajnues vijoi më pas me prezantimin e pjesëmarrësve përmes disa metodave inovative të cilat u pëlqyen nga ana e pjesëmarrësve.

**N**ë vijim, trajnimi vazhdoi me prezantimin e përkufizimeve dhe dallimeve midis roleve të iderit, lehtësuesit dhe koordinatorit. Në mënyrë që ky informacion të bëhej më i kuptueshëm, pjesëmarrësit u ndanë në grupe të vogla dhe diskutuan në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej roleve. Pjesëmarrësit diskutuan në lidhje me situata dhe shembuj konkret nga komunitetet e tyre. Një rëndësi e veçantë ju kushtua gjithashtu edhe sfidave dhe vështirësive me të cilat përballlet një person i cili është përgjegjës për role të ndryshme.

**G**jatë trajnimit pjesëmarrësit morrën informacion në lidhje me menaxhimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe fuqizimin e bashkëpunimit me Pushtetin Lokal. Një model i sukseshëm ishte ai i prezantuar nga z. Ferit Milanj, i cili ka ditur të krijojë një frymë bashkëpunimi shumë të mirë me komunitetin dhe Pushtetin Lokal në Lushnje.

**N**ë vijim të menaxhimit të marrëdhënieve me Pushtetin Lokal dhe komunitetin, menaxhimi dhe zgjidhja e konflikteve është një tjetër element shumë i rëndësishëm i punës së përditshme në terren. Konflikte të ndryshme mund të krjohen gjatë punës në komunitet. Punonjësit e terrenit duhet të jenë të aftë të lehtësojnë sa më shumë zgjidhjen e konflikteve

**G**jatë këtij sesi u bë edhe një prezantim i metadave të ndryshme që mund të përdoren për të shmangur apo zgjidhur konfliktet.

**N**jë fokus i veçantë iu kushtua edhe elementëve socialë dhe psikosocialë të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, duke shpjeguar hapat kryesore që kontribuojnë në një proces normal zhvillimi. Pjesëmarrësit mësuuan teknika të ndryshme për të njohur zhvillimin e fëmijëve në faza të ndryshme. Praktikrat tradicionale pozitive dhe negative u prezantuan gjithashtu gjatë trajnimit me qëllim për të bërë lidhjen midis traditës, kulturës dhe zhvillimeve moderne. Pjesëmarrësit ndanë me njëri-tjetrin histori nga praktika e punës në komunitet.

# Tryeza të rrumbullakta me ofruesit e shërbimeve në nivel lokal



**Viti Shkollor  
2015-2016**

**Korçë, Shkodër, Fier  
dhe Berat**

**N**ë vijim të fillimit të vitit shkollor 2015-2016, Unioni Amaro-Drom organizoi tryeza të rrumbullakta me pjesëmarrjen e ofruesve të shërbimeve në nivel lokal në Korçë, Shkodër, Fier dhe Berat.

**N**ë këto tryeza pati përfaqësues të Bashkive, Drejtorive Arsimore Rajonale, Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve, Drejtorive Rajonale të Shëndetit, zyravë të gjëndjes civile, zyrave të punës, qendrave të formimit profesional, drejtorë kopshtesh dhe shkollash, përfaqësues të shoqërisë civile, aktivistë dhe antarë të komunitetit rom.

**Q**ëllimi i organizimit të tryezave të rrumbullakta në këtë fazë të projektit ishte nxitja e dialogut midis ofruesve të shërbimeve për ofrimin e një mbështetje sa më efektive për antarët e komunitetit Rom, veçanërisht për fëmijët.



**N**jëkohësisht ky aktivitet synoi të kontribuojë në vlerësimin e boshllëqeve përsa i përket ofrimit të shërbimeve, rolit që çdo aktor mund të luajë dhe krijimin e një koordinimi më të mirë midis ofruesve privatë dhe publike të shërbimeve.

**D**isa prej çështjeve kryesorë të cilat u diskutuan gjatë tryezave të rrumbullakta dhe rekomandimet e dalë ishin:

- Drejtoritë Arsimore Rajonale kanë marrë të gjitha masat për përfshirjen e fëmijëve Rom në shkollë, vendosjen e edukatorëve dhe mësuesve të kualifikuar dhe të pregatitur në të gjitha nivelet arsimor. Sipas diskutimeve në tryezë, problem vazhdon të mbetet braktisja e shkollës nga fëmijët Rom. Të gjitha aktorët duhet të përpiqen që të parandalojnë këtë fenomen i cili zakonisht fillon të shfaqet disa muaj pas fillimit të vitit shkollor.
- Librat për fëmijët rom dhe egjiptianë janë shpërndarë falas për arsimin e detyrueshëm. Sipas përfaqësuesve të DAR-eve, problem mbetet identifikimi i fëmijëve rom dhe egjiptian dhe ukërku bashkëpunimi serioz i organizatave lokale romë dhe egjiptiane me qëllim që procesi të zhvillohet normalisht dhe librat t'i përfitojnë fëmijët për të cilët ato janë caktuar.
- Puna dhe lypja e fëmijëve romë në rrugë mbetet një shqetësim serioz për aktorët lokalë.
- Regjistrimi civil i popullsisë romë mbetet një shqetësim dhe kërkohen përpjekje më të koordinuara nga organizatat e shoqërisë civile për të trajtuar atë. Në këtë aspekt

veprimtaritë ndërgjegjësuere për regjistrimin civil duhet të vazhdojnë.

- Aktivitetepërrritjenendërgjegjësimi për parandalimin e migracionit të parregullt drejt vendeve të BE duhet të bëhen në zonat e komunitetit Rom. Njëkohësisht autoritetet lokale duhet të jenë të përgatitura për integrimin e rasteve të familjeve dhe fëmijëve të cilët kthehen pas refuzimit të azilit në vendet e BE-së.
- Duhet të bëhen përpjekje nga komunitetet romë në mënyrë që të kenë përfaqësuesin e tyre në Këshillat e Bashkive në rajonet përkatëse, si dhe të jenë më aktivë dhe të forcojnë bashkëpunimin me Pushtetin Lokal.
- Ndërmarrjen e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimi për regjistrimin në shkollë të fëmijëve romë, dhe për mundësitë me trajnime profesionale.
- Aktivitete ndërgjegjësuere për kujdesin shëndetësor dhe qasje në shërbimet shëndetësore në përgjithësi janë një domosdoshmëri në të gjitha zonat e projektit.
- Përmirësimi i infrastrukturës në shkollë dhe kopshte është një nga detyrat që duhet të përmbushet nga Bashkitë apo Njësitë Administrative në zonat përkatëse, me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e mësimi.

**G**jatë diskutimeve në tryezat e rrumbullakta, u vu re se shumë prej aktorëve nuk kishin informacion të plotë në lidhje me aktivitetet e institucioneve të ndryshme. Pjeëmarrësit e vlerësuan këtë aktivitet si një mundësi për të bashkëpunuar dhe për të ndërmarrë nisma të përbashkëta, bazuar në rolin dhe misionin e gjithsecilit.



## Sesione informimi mbi të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e regjistrimit civil

**N**ë muajt Korrik-Shtator 2015, Unioni "Amaro-Drom" realizoi disa sesione informese në komunitetet ku shtrihet projekti, në lidhje me të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e regjistrimit civil.

**K**y sesion trajnimi ndihmoi antarët e komunitetit Rom për t'u njohur me disa nga të drejtat kryesore të njeriut dhe për t'u ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka regjistrimi civil si një e drejtë themelore e individëve.

**N**jë nga parimet më të rëndësishme të legjislacioneve në Shqipëri dhe botë është që fëmija kur lind ka të drejtë të ketë një IDENTITET. Gjatë prezantimit juristja e Unionit "Amaro-drom" foli mbi të drejtat e njeriut cilat përbëhen nga: e drejta për identitet; e drejta personale; e drejta sociale, e drejta e fjalës; e drejta e barazisë; e drejta e pjesmarrjes në jetën politike etj. Ato janë të drejtat, të cilat kujdesen për mbrojtjen e njerëzve si të tillë nga ndërhyrja e shtetit, si dhe për paprekshmërinë e dinjitetit njerëzor.

**N**ë prezantimin e përgatitur, pjesmarrësit u njohën me të gjithë dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare që mbrojnë individët dhe garantojnë përfitimin e të drejtave të tyre.

**N**ë pjesën e dytë theksi u vu te shpjegimi i termit të "Regjistrimit civil" për antarët e komunitetit rom dhe egjiptian. Regjistrimi civil është posedimi i identitetit personal që secili prej nesh gëzon nëpërmjet përfitimit të emrit kur lind. Rëndësia e regjistrimit civil është një e drejtë themelore e cdo individi dhe cdo prind, duhet të ketë përgjegjësinë morale dhe ligjore për të regjistruar fëmijën e tij në zyrën e gjendjes civile, ku ka vendbanimin e tij.

**F**ëmija nëpërmjet fitimit të identitetit përfiton të gjitha shërbimet sociale falas si çdo qytetar pa dallime, të garantuara në legjislacionin shqiptar.

**G**jithashtu pjesëmarrësit mësuan se kush mund ta regjistrojë fëmijën në gjendjen civile. Fëmijën e regjistron nëna e fëmijës; babai i fëmijës nëse ka lidhur martesë ligjore me nënën e fëmijes ose të gjithë personat madhorë që rezultojnë në trungun familjar të nënës së fëmijës.

**N**jë hapësirë e veçantë gjatë këtij sesi informues ju kushtua edhe fëmijëve që lindin jashtë shtetit shqiptar dhe procedurat ligjore që kërkohen për të regjistruar fëmijët në vendin tonë.

# TRAJNIM PËR PRINDËRIT DHE KUJDESTARËT E FËMIJËVE



**P**ërgjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2015, në Shkodër, Korçë, Baltëz-Fier dhe Moravë-Berat u realizua në kuadër të projektit, trajnimi me temë “Procesi Normal i Socializimit të Fëmijëve 3-6 vjeç”.

**T**rajnimi kishte për qëllim, informimin e kujdestarëve të fëmijëve në lidhje me rëndësinë që ka në vetvete socializimi dhe se si ky proces influencon në zhvillimin e fëmijëve të grupmohës 3- 6 vjeç. Një hapësirë e veçantë gjatë trajnimit, ju kushtua rëndësisë që ka prindërimi dhe stilet e prindërimit në këtë stad zhvillimor.



# Programi i trajnimit u fokusua kryesisht në temat e mëposhtme:

- Njohja e kujdestarëve me stadet e zhvillimit normal të fëmijëve 3-6 vjeç dhe tipet zhvillimore .
- Si të evidentojmë kapacitetin zhvillimor të fëmijëve?
- Identifikimi i karakteristikave zhvillimore të fëmijës 3-6 vjeç dhe sfidat që hasin në këtë stad zhvillimor.
- Si lidhet socializimi primar i fëmijëve me sisteme të reja me të cilat fëmija ndërvepron?
- Rolin e prindërimit në mirëritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre.
- Rëndësia e përfshirjes së lojës tek fëmijët, jo si një mënyrë argëtimi se sa teknikë për të ndihmuar në zhvillimin e inteligjencës së tyre dhe kapacitetit të tyre zhvillimor.
- Roli i kujdestarëve në parapërgatitjen e fëmijëve për mjedisin e kopështit.
- Teknikat praktike për të mundësuar përshtatjen e fëmijëve në mjedisin e ri që është kopështi.

Në pjesën e parë të trajnimit, u fol në mënyrë përmbledhëse mbi rëndësinë e kësaj pakete informuese për prindërit dhe kujdestarët, për të marrë në këtë mënyrë, disa shprehje dhe teknika të reja në fushën zhvillimore të fëmijëve 3-6 vjeç. Theks i veçantë u vu në rëndësinë që ka socializimi dhe roli i kujdestarëve të fëmijëve në përgatitjen e tyre për mjedisin e kopështit. Kjo padyshim ngjalli interes nga ana e pjesëmarrësve e sidomos nga prindërit. Gjatë trajnimit, u mundësua përfshirja në diskutime e prindërve dhe kujdestarëve të tjerë të fëmijëve në mënyrë që të krijohet një ambjent sa më interaktiv dhe gjithpërfshirës.

Në fund të secilit sesion ishin hartuar një sërë pyetjesh apo dhe situata praktike nga jeta e përditshme në marrëdhënien prind – fëmijë, duke u ofruar në këtë mënyrë teknika dhe shprehje të reja mbi stilet e prindërimit.

Eksperjencat e prindërve në mirëritjen e fëmijëve të tyre ishin të ndryshme, qëllimi i ndarjes së këtyre eksperiencave nuk kishte si synim evidentimin se kush nga ato eksperiencia ishte më e duhura, sepse nuk ka një recetë të mirfilltë për të orjentuar prindërimin më të mirë, por informimi i duhur në këtë drejtim, do t'i ndihmojë këta kujdestarë se si të japin maksimumin e tyre duke i mundësuar një mjedis zhvillimor fëmijëve të tyre.

Nga ky trajnim prindërit mësuajnë disa shprehje dhe teknika në lidhje me zhvillimin normal të fëmijëve të tyre;

Mësuajnë se zhvillimi normal i fëmijëve të tyre nënkupton zhvillimin fizik, emocional, mendor dhe social të fëmijës;

Evidentuan se në këtë stad zhvillimor fëmija zhvillon një mori emocionesh si: atë të frikës, empatisë, vetsigurinë etj;

Kuptuan gjithashtu mbi rëndësinë që ka roli i tyre për kujdesin në krijimin e një mjedisi mbrojtës, të sigurt dhe mbështetës për fëmijën dhe rëndësinë që ka gjithsecila prej tyre;

Familja është ajo që i jep mundësinë fëmijës se si të ndërveprojë me anëtarët e tjerë brenda familjes, se si të ndërmarrë rolet e para dhe se si të vendosë marrdhëniet e para njerëzore, mbi të cilat do të mbivendosë të gjitha marrdhëniet e tjera shoqërore e sociale, në habitate të reja në stadet e mëtejshme zhvillimore.

Ndërgjegjësimi në lidhje me rëndësinë që ka stili i prindërimit dhe modeli që ajo paraqet.

## Përfundimet e arritura nga trajnimi:

**Anjeza Kolami**  
Trajnuese

# SHKËMBIM EKSPERIENCË MIDIS STAFEVE EDUKATIVE TË KOPSHTEVE NË SHKODËR

10-11 Dhjetor



Kopshti  
"Liria" Shkodër



Në datat 10-11 Dhjetor 2015, në kopshtin "Liria" Shkodër u zhvillua aktiviteti shkëmbim eksperience midis stafeve edukative të kopshteve "Lulet e vogla" Korçë, "Hamil" Fier dhe kopshti i lagjes "Stan-Moravë" Berat.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Rome" financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect, i cili zbatohet nga Unioni "Amaro-Drom në zonat e sipërpërmendura. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të kontribuonte në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shkëmbimin e eksperiencës midis stafeve edukative të kopshteve të targetuara nga projekti.



Në këtë aktivitet morën pjesë edukatorët, drejtorët e kopshteve dhe koordinatorët lokalë të zonave të projektit.

Pritja në ambjentet e kopshtit dhe shkollës "Liria" u bë nga Drejtori z. Petrit Proni, i cili i shoqëroi pjesëmarrësit për të bërë një vizitë në të gjitha klasat e shkollës dhe ambjentet e drejtorisë. Ai bëri një prezantim të historikut të krijimit dhe funksionimit të kësaj shkolle. Shkolla "Liria" është një shkollë e cila frekuentohet 100% nga fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Ajo është një shkollë 9 vjeçare dhe brenda ambjenteve të shkollës ekziston edhe kopshti për fëmijët 3-6 vjeç. Klasa e kopshtit është një klasë e përbërë nga tre gupe dhe mësimi jepet nga dy edukatore të kualifikuara të cilat janë në caktuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër. Për shkak të mungesës së ambjenteve dhe largësisë së shkollës nga vendbanimi i tyre, një grup i përbërë nga 15 fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç e zhvillojnë mësimin në ambjentet e "Fshatit të Paqes". Edhe ky kopsht është në varësi të drejtorisë së shkollës "Liria".

Më pas, pjesëmarrësit ndoqën zhvillimin e një ore mësimore në kopshtin e Shkodrës, ku patën mundësinë të njihen me metodat e mësimdhënies dhe si organizohet një orë mësimi në këtë kopsht. Stafet edukative të kopshteve të tjera, vlerësuan punën e edukatoreve për përfshirjen e fëmijëve dhe aktivizimin e tyre gjatë orës së mësimi.

Në aktivitet ishte e pranishme gjithashtu edhe specialistja nga Instituti i Zhvillimit Arsimore, Ministria e Arsimit dhe Sportit, e cila është duke zhvilluar trajnimin në punë për edukatorët. Ajo e vlerësoi së tepërmi aktivitetin, duke theksuar se gjithnjë edhe më tepër po i kushtohet rëndësi cilësisë së mësimdhënies në kopshtet publike dhe aktivitete të tilla, kontribuojnë në këtë drejtim.

Më pas, aktiviteti vazhdoi në kopshtin që ndodhet në ambjentet e "Fshatit të Paqes".

Ky kopsht ka një kapacitet deri në 16 fëmijë. Të gjithë fëmijët që janë në këtë kopsht, por edhe fëmijët nga klasa e parë në të katërt, janë fëmijë me probleme të theksuara social-ekonomike, janë fëmijë të cilët janë larguar nga rruga dhe janë afruar pranë institucioneve arsimore.

Për të gjithë fëmijët të cilët zhvillojnë mësimin në ambjentin e "Fshatit të Paqes" ofrohet ushqim. Kjo gjë ndikon shumë pozitivisht në frekuentimin e rregullt të kopshtit dhe shkollës nga fëmijët, u shpreh z. Proni, Drejtori i shkollës "Liria". Sipas tij, nëse do të ofrohej ushqim edhe në ambjentet e shkollës, nuk do të ekzistonte asnjë problem me frekuentimin e shkollës dhe kopshtit nga fëmijët.

Në vijim të vizitave në të dyja ambjentet e kopshteve, pjesëmarrësit diskutuan dhe ndanë eksperiencat midis tyre, duke përmendur vështirësitë kryesore me të cilat ata janë përballur gjatë punës së tyre. Znj. Havajana e cila është një ndër mësueset e para që ka dhënë kontributin e saj që në momentin e hapjes së "Fshatit të Paqes", foli mbi historikun e krijimit të tij dhe ndihmën e çmuar që ka dhënë i gjithë personeli për fëmijët në nevojë. Aktiviteti u përbyll me një koktejl i cili ishte organizuar për pjesëmarrësit nga stafi i "Fshatit të Paqes" në bashkëpunim me drejtorin e shkollës "Liria".

# KRENARE PËR KONTRIBUTIN QË MUND TË JAP PËR FËMIJËT ROM EKSPERIENCË PERSONALE



Qudem Olivera Rapushi, jam 26 vjeç dhe kam mbaruar studimet e larta për cikël të ulët parashkollor në Universitetin e Korçës F.S.Noli..

Unë vij nga komuniteti rom dhe si e tillë, arsimimi im nuk ka qënë tepër i lehtë, pasi të dy prindërit e mi kanë qënë puntorë të thjeshtë dhe paga e tyre nuk ishte e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e shkollës. Por, pavarësisht gjëndjes së ulët social-ekonomike, prindërit e mi, të cilëve sot u jam mirënjohëse, bënë të mundur që të përfundoja me sukses studimet e larta. Përveç vështirësive social-ekonomike të cilat i hasim cdo ditë, për mua ka qënë e vështirë edhe ndjekja e shkollës. Shpesh herë jam ndjerë e diskriminuar nga shoqëria, por kjo gjë nuk më ka dekurajuar dhe penguar për të ecur përpara dhe pavarësisht këtij problemi, nuk u dorëzoza asnjëherë për të arritur qëllimin që unë kisha.

Përveç sakrificave dhe mundimeve të familjes sime, të cilët kanë qenë një mbështetje e madhe për mua, dua të përmend këtu dhe njëkohësisht të falenderoj Organizatën e Romëve të Shqipërisë "Amaro-Drom" e cila shumë herë ka qenë një ndihmë për mua, duke bërë të mundur përjashtimin për pagesën e kuotës së universitetit, si dhe përfshirjen e dhënies së bursës për 2 vjet nga organizata SOROS

Gjithashtu, dua të falenderoj edhe një herë këtë organizatë për mbështetjen dhe ndihmën që më ka dhënë për të gjetur një punë në profilin tim. Sot, falë organizatës "Amaro-Drom", Drejtorisë Arsimore Korçë si dhe Institucioneve të tjera, unë jam punësuar që prej dy vjetësh si edukatore pranë kopshtit "Lulet e vogla".

Në këtë kopsht, kontributi im nuk do të jetë thjesht si një edukatore, e cila do të zbatojë planet e saj mësimore, por edhe si pjesë e këtij komuniteti. Synimet e mia, nuk janë vetëm që fëmijët e komunitetit rom të mësojnë dhe të marrin njohuri rreth fushave të ndryshme të zhvillimit të tyre, por gjithashtu edhe t'i ndihmoj ata, të rrisin besimin në vetëvete, të ruajnë kulturën, traditën dhe gjuhën e pastër që ne kemi. Të mësojnë se jeta, është e vështirë por gjithashtu dhe e lehtë kur dimë t'i zgjidhim butësisht problemet që ajo na sjell, t'i ndihmoj ata të edukohen me ndjenjën dhe dëshirën e arsimimit të mëtejshëm për t'u bërë kështu në të ardhmen njerëz që do të integrohen dhe do të rrisin nivelin dhe vlerat e shoqërisë ku ne jetojmë.

Përpara se ta mbyll këtë përshkrim të shkurtër, do të doja të jepja një mesazh për të gjithë prindërit dhe të rinjtë rom: "Pavarsisht vështirësive social- ekonomike që ne mund të kemi dhe problemeve të ndryshme që na sjell jeta, mos neglizhoni dhe mos u dorëzoni asnje ditë në dërgimin e fëmijëve tuaj në shkollë, pasi ata, jo vetëm që janë e ardhmja juaj, por janë dhe e ardhmja e këtij Kombi dhe e gjithë shoqërisë njerëzore.

**Olivera Rapush**

Edukatore e kopshtit "Lulet e vogla" Korçë

# PUNA ME FËMIJËT ROM MË JEP KËNAQËSI



Quhem Aida Ferdinand Rustemi, kam lindur në qytetin e Korçës më 30 Janar 1985. Mbas përfundimit të shkollës së mesme, më plotësohet dëshira shpirtërore për të punuar me fëmijët, ku fitoj të drejtën e studimit në universitetin “Fan.S.Noli” në qytetin e Korçës, Fakulteti i Mësuesisë dega Parashkollor, në vitet 2003-2006.

Mbas diplomimit, jam emëruar si mësuese në kopështin “Lulet e Vogla” kopësht i cili njësoj si unë, ishte në fillimet e veta. Ky kopësht, frekuentohet kryesisht nga fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian. E ndiej për detyrim moral të shpjegojem se fëmijët e këtij komuniteti, jo vetëm më janë dhembur, por më janë bërë pjesë e jetës sime. Qysh në kontaktet e para, i konsiderova si fëmijët e mi, sepse edhe unë jam nënë dhe si nënë, dhembësoria i kalon caqet e lagjes nga vijnë, i kalon barrierat dhe barrikadat e ngjyrës dhe të bën fisnik tek përqafton, ledhaton, merr në prehër e puth këta fëmijë nënash që ndoshta ( në shumë raste ekonomia iu ka ulur kokën). Edhe unë, sa krenare aq dhe e vlerësuar, për ta kaloj nga caku i edukatores tek nëna. Kjo gjë më mbush me emocione që i kalojnë kufijtë.

Kopështi “Lulet e Vogla” u hap në datën 8 Prill 2007 në Ditën Ndërkombëtare të Romëve. Nuk ka arsye të mos shprehem sinqerisht se vështirësitë e punës në ditët e para ishin të mëdha dhe ndonjëherë të pa parashikueshme. Vështirësitë më shtoheshin edhe kur përballesha

me neglizhencen e disa prindërve apo vështirësitë në komunikim. Por këto raste sporadike, nuk më dekurajuan por më dhanë forcë për të realizuar ëndrrën time që gjithcka do ta vë në shërbim të këtyre fëmijëve.

Është vendi të theksoj se këto vështirësi, i kapërceva fal mbështetjes maksimale dhe tepër profesionale të koordinatores Rome znj. Donika Rapushi, për të cilën flitet me respekt dhe konsideratë në sektorin edukativ të linjës tonë dhe në veçanti në qytetin e Korçës. Bashkëpunimi jonë ka qenë tepër frytdhënës sepse këtë gjë e vërtetojnë vetë brezat e fëmijve që kanë qenë në kopshtin tonë dhe është momenti të përmend një postulat latin ku thuhet “ Ku ka punë ka jetë, ku ka punë ka fitore”.

Për këtë gjë jam krenare sepse dijet e marra të shkollës, kur gërshetohen me eksperiencën në punë, të bëjnë që shumë shpejt ta ndiesh veten të aftë në një detyrë dhe kompetente në vlera të merituar nga instancat që ta kanë besuar këtë detyrë. Vleresimin akoma më të madh ma kanë dhënë prindërit e komunitetit rom dhe egjiptian që tashmë kanë filluar të më konsiderojnë si bijën e tyre.

Dua të bëj me dije në mënyrën më të ndërgjegjëshme se, nuk e kam absolutisht të vështirë por as të pamundur, që gati cdo ditë, të takohem me nënat e fëmijëve, të ulem edhe në vatrat e tyre, e pse jo ta pi edhe një kafe me to. Unë sot po hyj në vitin e nëntë të punës time, por këto vite, jo vetëm që kanë qenë të mbushura me variacione pune gjithnjë e më dinamike, po më kanë dhënë shanse për të përmirësuar metodikën e librave të lidhur tashmë e të gërshetuar me praktikën dhe për më tepër me një praktikë në një sektor delikat dhe të vështirë.

E gjykoj të arsyeshme që edhe për periudhën në vazhdim, jo vetëm do të punoj për ngritjen time edukative profesionale, por mendoj që të evidentoj eksperiencën time disa vjeçare dhe të krijoj një “ Manual profesional”. Ndihem e barabartë me koleget e mia, nuk ndihem aspak fillestare por dinjitoze dhe krijuese në çdo etapë të punës time, nuk ndihem aspak e lodhur por e etur për të gjetur e thithur metodat bashkëkohore, për ta bërë ditën e punës frytdhënëse e të gëzuar siç e dëshirojnë të gjithë fëmijët kudo në botë.

Është momenti të bëj prezent, dhe pa më të voglin hezitim mbështetjen maksimale që kemi pasur nga organizata më e madhe Rome në Shqipëri “Amaro Drom”, e cila fal stafit të saj të përkushtuar dhe të kualifikuar, ka qenë bashkëudhëtarja jonë në rrugën drejt dijes. Në kopësht është krijuar një ambient i ngrohtë dhe çlodhës ku fëmijët kalojnë një pjesë të ditës dhe e gjithë baza materiale dhe didaktike është mundësuar përsëri nga Amaro Drom.

**Aida Rustemi**

Edukatore e kopshtit “Lulet e vogla” Korçë



# KONTRIBUTI I "FSHTATIT TË PAQES" NË ARSIMIMIN E FËMIJËVE ROM DHE EGJIPTIANË NË SHKODËR

Në Shkodër jeton një numër i madh banorësh të komunitetit rom dhe egjiptian. Komuniteti egjiptian vendbanimin e ka në dy anët e lumit Buna në hyrje të qytetit, rrzë kalasë dhe malit të Taraboshit. Një pozicion shumë i bukur gjeografik, por me probleme sociale dhe ekonomike që i kanë shoqëruar në vite.

Disa nga banorët egjiptianë dhe rom jetojnë në lagjen Tej Buna, rrzë malit të Taraboshit. Kushtet e tyre ekonomike e sociale janë shumë të vështira. Një nga këto është se shkolla për fëmijët është larg vendbanimit të tyre, prandaj nuk vazhdonin shkollën.

Fshati i Paqes është pozicionuar afër vendbanimit të tyre. Ai reflekton që në pamje paqe e mirësi dhe në vite, u bë krah në ndihmë të komunitetit. Duke parë kushtet e vështira, Misioni i Fretërve Kapuçinë që ndodhen me vendbanim pranë këtij komuniteti, financuan për hapjen e kopshtit dhe shkollës fillore në "Fshatin e Paqes".

Hapja e shkollës u mirëprit nga banorët e lagjes. Shkolla është aneks i shkollës "Liria".

Ajo filloi veprimtarinë e saj në vitin 1999 dhe vazhdon edhe në ditët e sotme ku funksionon shumë mire.

Kopshti parashkollor si dhe ambientet e klasave janë për t'u admiruar. Me mbarimin e ciklit fillor nxënësit vazhdojnë ciklin 9-vjeçar në shkollën "Liria".

Drejtorja e shkollës "Liria" kryen kontrolle sipas një plani të caktuar në drejtim të procesit mësimor duke dhënë ndihmën e saj në këtë drejtim.

Integrimi i fëmijëve rom dhe egjiptian është motoja e shkollës. Bëhen takime e shfaqje me shkollat e tjera.

Veprimtaria e kësaj shkolle është pasqyruar në televizionet lokale e në televizionin Italian më shumë se një herë.

Me fëmijët punon një staf i përkushtuar me përvojë në mësimdhënie. Angazhimi i Misionit të Fretërve Kapuçinë është shumë i madh. Në këtë drejtim nxënësve nuk u mungon asgjë që nga mëngjesi e dreka që e marrin në shkollë, deri tek paisja me mjete shkollore e veshmbathje.

Shkolla nuk ka lënë jashtë vëmendjes edhe aktivitetet artistike e kulturore. Në mjedisin e tyre ka fëmijë të talentuar që kanë marrë pjesë edhe në festivalet për fëmijë.

Ju ftojme me kënaqësi në shkollën tonë. Kjo shkollë vizitohet shumë nga grupe dhe individë të veçantë nga vendi dhe të huaj, të cilët bashkëpunojnë dhe japin ndihmesën e tyre.

**Havajana Tabaku**  
"Fshati i paqes" Shkodër

# INFORMACION MBI SHKOLLËN "LIRIA" NË SHKODËR

Në Shkodër jeton një numër i madh i komunitetit rom dhe egjiptian. Komuniteti egjiptian jeton në një lagje të quajtur lagjia "Liria" dhe pjesa më e madhe është e përqëndruar në këtë lagje, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë dhe e integruar në jetën sociale të qytetit të Shkodrës.

Prej shumë vitesh ky komunitet ka patur shkollën e tyre e cila ishte një shkollë fillore dhe më pas vazhdonin në shkollën "Isuf Tabaku" në Ajasëm.

Në vitin 1990 shkolla u dogj dhe më pas u mor nga pronari dhe për disa vite nuk kishte shkollë fare.

Në vitin 1998 u bë e mundur hapja e shkollës në ambientet e një shtëpie në lagje, të marrë me qera, kjo falë edhe ndihmesës së një shoqate "Refleksion" e cila bëri të mundur edhe trajtimin me ushqim të këtyre fëmijëve që e rriti ndjeshëm frekuentimin e shkollës.

Me ndërhyrjen e shumë aktorëve dhe me kërkesën e vazhdueshme të stafit mësimor, në Janar 2007 u bë e mundur hapja e shkollës së re në lagjen "Liria" kjo e ndërtuar nga qeveria shqiptare. Në këtë shkollë vazhduan mësimet rreth 80 nxënës dhe 30 fëmijë parashkollor, por më pas pati probleme sepse këta fëmijë pasi mbaronin klasën e V-të nuk e vazhdonin në shkolla të tjera.

Në vitin 2010 ne inisiativën e mësuesve u bë e mundur mbledhja e të gjithë fëmijëve që kishin mbaruar shkollën fillore dhe ishin në rrugë, gjë e cila bëri të mundur edhe hapjen e klasës së 6-të dhe ku nga ai moment shkolla në lagjen "Liria" funksion si shkollë 9-vjeçare dhe ka nxjerrë shumë breza.

Sot shkolla ka rreth 130 nxënës dhe 30 fëmijë në kopësht.

Përsa i përket pjesës tjetër të këtij komuniteti është shpërndarë në shkolla të tjera të qytetit të Shkodrës.

Shkolla	Nr. i nxënësve
Ndre Mjeda	60
Ali Laçej	20
Solo Halili	30

Ky komunitet autokton në Shkodër është i gjithi i sistemuar në shkolla, por problemi më i madh mbetet komuniteti rom të cilët janë vendosur në disa vendbanime dhe të cilën nuk frekuentojnë shkollën dhe janë të regjistruar në rrethe të tjera.

**Petrit Proni**

Drejtor i shkollës "Liria" Shkodër



## EDUKIMIN E FËMIJËS E NDËRTON NËNA

**I**ntegrimi i Komunitetit Rom, fillon në rrrënjët e fëmijërisë së hershme, ku maja e piramidës së integrimit duhet të jetë arsimimi. Arsimi është oguri i jetës që cdo individ i shoqërisë duhet të ketë. “Arsimi ul paragjykimet, të përfshin në shoqëri, të rrit në integritet.”

**P**ër të investuar në arsimin e fëmijëve Rom, Unioni “Amaro Drom” i mbështetur nga Roma Education Fund (REF) zbaton në katër zonat e Shqipërisë (Elbasan, Kucove, Grabian, Levan) projektin “Mbyllja e hendekut midis fëmijëve rom dhe jo-rom në Zhvillimin e fëmijërisë së hershme në Shqipëri”. Ky projekt gjen zbatimin që nga muaji Maj 2014 deri në Maj 2016, ku i vjen në ndihmë 183 fëmijëve Rom të grupmoshës 3-6 vjec.

### Të dy aktorët kanë si qellim:

- Zhvillimin e fëmijërisë së hershme.
- Rritjen e numrit të rregjistrimit të fëmijëve rom në kopshte
- Parandalimi i fenomenit të braktisjes së arsimit
- Nxitja për arsimin para-universitar.




Shkak i mentaliteteve dhe shkaqeve social-ekonomike, kanë bërë që arsimiti i prindërve të fëmijëve romë, i theksuar tek nënat romë është i ulët. Ndër vite, kjo situatë është duke ndryshuar me anë të punës që bëhet në komunitet. Ky projekt, përgatit nënat për t'i edukuar fëmijët e tyre me anë të librave. Ndihej që të krijojë një raport social në mardhënien nënë-fëmijë. "Historia juaj" është linja e krijimit të rrjetit të nënave romë në katër komunitetet target të projektit. Seancat me nënat të cilat relizohen nga Lehtësuesja kanë krijuar pikën kryesore të aktiviteteve në projekt.

Projekti mundohet të realizojë një socializim midis nënave, një ambient ndryshe nga monotonia e përditshme duke i dhuruar çdo sencë një libër me përralla.

Përveç faktit që nënat mësojnë si t'i lexojnë një libër fëmijës së tyre, ato tashme kanë krijuar një bibliotekë në shtëpi, ku realisht nuk do mundeshin ta krijonin këtë pasuri dijetsh për të vegjëlit e tyre. Ne mundohemi të integrojmë më shumë se 48 nëna dhe i nxisim ato që të integrojnë fëmijët e tyre. Mundohemi t'i bindim që arsimiti është i rëndësishëm për fëmijët dhe mos të lejojnë që ata të kalojnë të njëjtën situatë që vet nënat kanë kaluar duke mos përfituar një nga të drejtat bazë të njëriut, atë për t'u arsimuar.

Të implementosh një mision të tillë si ai që projekti ynë përfaqson, ndryshon dhe jetën e një ose më shumë individëve. Një nga rastet pozitive është dhe Zonja Ruzhdie. Një nga katër Lehtësueset Lokale të projektit. Ajo është një nënë romë e cila jeton në Grabian dhe misioni i saj është që të ndërgjegjësojë nënat e reja për rëndësinë e arsimimit të fëmijëve.





"Unë e martova vajzën time të vogël, pa ditur që në jetë arsimit është primar" shprehet Ruzhdija.

Ruzhdija është Lehtësuese e cila organizon seancat me nënat "Historia juaj". Ajo mundohet çdo ditë të planifikojë takimin me to. Ditët e saj kalojnë në shoqërinë e rrjetit të nënave në Grabian, të cilat bisedojnë rreth librit me përralla, mjetet që përdorin për të treguar historinë e asaj përralle dhe pse jo, bisedojnë për ëndërrat që fëmijët e

tyre kanë. Nga takimi i parë me Ruzhdijen ajo ishte një grua shumë e thjeshtë, e ndrojtur dhe e pasigurt për misionin e saj. Puna ndër muaj e bëri atë të ndryshojë, sigurisht të ndryshojë për mirë. Sjellja, komunikimi, paraqitja dhe entuziazmi i saj ndryshuan ndër muaj. Tashmë kemi një grua Rome aktive e cila do të jetë shembull për nënat e Komunes Grabian por pse jo, shembull për gjithë nënat Rome në Shqipëri. Krenohemi me të!

Dhe pas Zonjës Ruzhdije, janë edhe tre zonja të tjera të cilat drejtojnë këtë program të mbrekullueshëm dhe tepër produktiv. Zonja Enkeleda, një nënë Rome e arsimuar përpjet që të edukojë nënat e zonës Elbasan, që ato të jenë të afta për të edukuar dhe mirërritur fëmijët e tyre. Zonja Farije, drejtuesja e grupit të nënave Rome në Levan me anë të këtij program vazhdon misionin e saj për të krijuar integritet në zonën ku banon. E fundit por jo më pak e rëndësishmja, është Zonja Rape një Grua Rome aktiviste e cila jep gjithmonë shembullin e saj për nënat Rome të Kuçovës.

Mbas këtij përshkrimi të shkurtër të projektit, e vetmja gjë që shpresojmë janë rezultate në rritje dhe sukses në implementimin e tij. Njeriu ka nevojë për njeriun dhe fati ynë me i madh është që kemi në dorë të ndryshojmë jetën e njëzve tanë. Ata kanë nevojë për ne dhe ne do i gjendemi pranë. Të pasurosh shoqërinë Rome me dije dhe arsim, ke shtuar një vlerë të madhe në shoqëri.



**Anila Harapi**

Koordinatorë Projekti "Mbyllja e hendekut midis fëmijëve Rom dhe jo-Rom në Zhvillimin e fëmijërisë së hershme në Shqipëri"

Botim i Unionit "Amaro-Drom" Nr. 1, Dhjetor 2015